



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SKRAPAR

RELACION

**PËR DHËNIEN E NDIHMËS FINANCIARE PËR SHTETASËN MAJLINDA ÇUNI
BANORE NË NJËSINË ADMINISTRATIVE ÇOROVODË, BASHKIA SKRAPAR**

Spektori i Shërbimit Social bazuar në kërkesën e bërë nga shtetasja **Majlinda Çuni** më datë **03.10.2024**, si dhe në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen Vendore”, neni 24, “Funksionet e bashkive në fushën e shërbimeve sociale”, pikal, bashkitë janë përgjegjëse për krijimin dhe administrimin e shërbimeve sociale, në nivel vendor, për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët, gratë, gratë kryefamiljare, gratë e dhunuara, viktimat të trafikut, nëna apo prindër me shumë fëmijë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj, si dhe Vendimit të Këshillit të Bashkisë nr.44, datë 15.12.2023”, për buxhetin e Bashkisë Skrapar dhe institucionet në varësi të saj:

JU RELATOJ:

Familja e **Znj. Majlinda Çuni** me banim në qytetin e Çorovodës, Bashkia Skrapar, e përbërë prej dy anëtarësh, kryefamiljari dhe bashkëshortja.

Znj. Majlinda Çuni për shkak të një aksidenti automobilistik, prej shumë vitesh ka patur probleme me shëndetin fizik dhe dhimbje në gjurin e djathtë, kufizim i lëvizjes, çalim gjatë ecjes si pasojë e dhimbjes. Ka kryer ndërhyrje kirurgjikale për të lehtësuar dhimbjet dhe lëvizjen e gjurit.

Operacioni ka kushtuar rreth 7 mijë Euro dhe është detyruar të marri lekë borxh.

Nuk ka mundësi ekonomike të shlyej detyrimet dhe borxhet pasi bashkëshorti trajtohet me pagesë invaliditeti prej 30 vitesh dhe vet me një pagë minimale prej 35.000 lekë, si punonjëse në Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike në Bashkinë Skrapar.

E ndodhur në këto kushte të vështira ekonomike për Znj. Majlinda Çuni Bashkia Skrapar merr përsipër dhënie e ndihmës financiare në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë.

Për sa më sipër, i propozojmë Këshillit Bashkiak dhënie e ndihmës financiare për shtetasen Majlinda Çuni.

**Përgjegjëse e NE dhe PAK-së
Teuta Hysenbelliu**

